



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 652 Prot.

Tiranë, më 08.05 2019

**VENDIM Nr. 108, datë 2.05.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48 dhe *VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit *"Rikonstruksion dhe shtesë volumi" Lagjja Nr. 12, rruga "Vasil Kuqi", zonë arkeologjike "B" Durrës"*- subjekti Z. Suat Sula.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën për zhvillim të projektit "Rikonstruksion dhe shtesë volumi" Lagjja Nr. 12, rruga "Vasil Kuqi", zonë arkeologjike "B" Durrës"- subjekti Z. Suat Sula.
2. Subjekti Z. Suat Sula, të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, subjekti Z. Suat Sula duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me DRKK Durrës, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të zbatimit për themelet deri në kuotë  $\pm 0.00$ , për projektin *"Rikonstruksion dhe shtesë volumi" Lagjja Nr. 12, rruga "Vasil Kuqi", zonë arkeologjike "B" Durrës"*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të realizojë mbikëqyrjen e punimeve.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)